



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**A nr. 1103/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e Arjetë Nezaj kandidate për asamble kuvendit komunal nga rradhët e subjekti politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK) nga Komuna e Prizrenit, paraqitur kundër Destan Hoti për shkak të parregullsive dhe manipulimit të votave gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Arjetë Nezaj kandidate për kuvendin komunal në Prizren nga subjekti politik LDK .

#### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.12.2013, nga Arjetë Nezaj anëtare nga subjekti politik LDK, e cila thekson se në qendrat e votimit 2005A/01R ku ajo mendon se i ka pasur 55 vota. Në fshatin Gjonaj në qendrat e numrimit 2015A/02, 2015/03R, 0215/04R, 2015/05R ajo pretendon se i është bërë manipulim me vota. Të njejtin mendim e ajo e ka edhe në qendrën e votimit me numërimin 2050A/01R, si dhe në qendrën e votimit 2018A/012R dhe kërkon që të bëhet rinumrimi i votave të saj dhe mendon se i është bërë shkelje dhe manipulim i votës së lirë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshëm pretendimet ankimore të ankuesës Arjeta Nezaj nga komuna e Prizrenit PZAP-i, i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse siç pretendon pala ankuese andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullorës së PZAP-i lidhur me ankesën e lartpërmendura vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 1103/2013 më datën 06.12.2013



**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

***Këshillë Juridik:***

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës mbrenda 24 (njëzetkatër) orë nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i.